

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Aksidentet rrugore në gusht 2026, ulet numri i ngjarjeve mujore, por rritet me 6,2% bilanci i 8-mujorit
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/28/aksidentet-rrugore-ne-gusht-2026-ulet-numri-i-ngjarjeve-mujore-por-rritet-me-62-bilanci-i-8-mujorit/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 17:43:38 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 17:42:26 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5df1fc0a90ef7717d73b2bd9b5408b121fe46e6457ac06fb2e8befe7d1a5fdd7
TEKSTI	75a23586d8dc5de114165c6d1eed07860f5da00bd0e9d31c235cb59f45d5bf9e
PAMJA	b79725f7bffa89616e9e5d314000ef1e4c07100b4cdba87aaf56fe1e2f6bde50

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	217ae4ca5c2af7e51733a756faf695b66aff56eebea8b3b55810d3a3fede0227
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	e5625a2b3a70b3c40eaff938d2f4a87fb4cf81b6cc2ef2b38db74408074a14f5
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/217ae4ca5c2af7e51733a756faf695b66aff56eebea8b3b55810d3a3fede0227>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Aksidentet rrugore në gusht 2026, ulet numri i ngjarjeve mujore, por rritet me 6,2% bilanci i 8-mujorit

Aktualitet

Publikuar: 28/09/2026



Sipas të dhënave zyrtare të publikuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), mbështetur në raportimet e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, gjatë muajit gusht 2026 janë regjistruar 139 aksidente rrugore. Nga këto ngjarje, 191 persona kanë mbetur të aksidentuar (kanë humbur jetën dhe janë plagosur), duke shënuar një ulje krahasuar me gushtin e vitit 2025, ku u regjistruan 159 aksidente me 229 të aksidentuar.

Pavarësisht rënies gjatë muajit të fundit të verës, tendenca e përgjithshme për vitin 2026 mbetet në rritje. Gjatë harkut kohor janar-gusht 2026, numri i aksidenteve rrugore është rritur me 6,2 % krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke arritur në 983 aksidente me një bilanc prej 1.378 personash që kanë humbur jetën apo janë plagosur.

Faktorët kryesorë, shkeljet e drejtuesve, orari i mbrëmjes dhe moshë e re

Faktori njeri mbetet shkaku kryesor i ngjarjeve rrugore. Gjatë gushtit 2026, 86,3 % e aksidenteve kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së drejtuesve të mjeteve, të tilla si mosrespektimi i normave të shpejtësisë apo i sinjalistikës rrugore.

Analiza sipas grupmoshave dhe fashave orare tregon se rinia dhe orët e mbrëmjes mbajnë peshën kryesore të rrezikut në rrugë. Përdoruesit e rrugës të moshës 25-34 vjeç paraqesin numrin më të lartë të ngjarjeve, duke përbërë 31,7 % të totalit të aksidenteve.

Me të lexuarat



Nga Hati tek prokurori i SPAK, personazhet në videot e Gys (aksidentat)



Veshaj që i blenë Fidel Yllit për 300 mijë euro,



biznesmenia të pafatshme e fletës së Alket Rizait, mes burgjeve të Greqisë dhe arratisjeve



spektakolare Kumbaret e kokainës/ Nga Kolumbia e Ekuadori në Europë, si u trafikuan mbi



Dosja e drogës Sherbimit Sekret: Si i hapte dyert e Portit të Durrësit Liburn Aliu, me urdhër të Vlora Hys...

Orari më problematik është harku kohor nga ora 19:00 deri në 24:00, l cili ka regjistruar 20,1 % të aksidenteve të muajit. Dita e hënë ka shënuar numrin më të lartë të aksidenteve me 18,0 %, ndërsa ditët e mërkurë dhe e premte kanë pasur nivelin më të ulët, me nga 11,5 % secila.

Shpërndarja gjeografike, Tirana dhe Durrësi kryesojnë me numrin më të lartë të ngjarjeve

Në nivel qarkesh, Tirana vijon të mbajë peshën kryesore të aksidenteve në shkallë vendi. Gjatë muajit gusht 2026, në kryeqytet u regjistruan 33 aksidente me 38 të aksidentuar, ndërsa në bilancin 8-mujor (janar-gusht), Tirana numëron 369 aksidente me 457 të aksidentuar (nga 270 aksidente në të njëjtën periudhë të vitit 2025). Pas Tiranës, qarku i Durrësit ka shënuar një rritje të ndjeshme gjatë gushtit me 24 aksidente dhe 36 të aksidentuar (nga 8 aksidente që kishte në gusht 2025), i ndjekur nga Lezha me 21 aksidente. Në krahun tjetër, qarqet si Berati dhe Dibra nuk kanë regjistruar asnjë person të vrarë apo të plagosur gjatë muajit gusht 2026.

“Gjatë periudhës janar-gusht 2026, numri i aksidenteve rrugore është rritur me 6,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë,” theksohet në raportin e INSTAT-it, ku sqarohet se “86,3 % e aksidenteve rrugore kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së drejtuesve të mjeteve.”

TAG:

Aksidentet rrugore

gusht 2026

Të ngjashme



Edmond Spaho: Opozita di të bëjë vetëm zhurmë në Kuvend! Mazhoranca nuk është lëkundur



Përplasja për rregulloren, GJKKO në kolaps, 3 javë pa gjyqe



Erion Braçe shkon të vizitohet në QSUT dhe befasohet nga ministrja e re: Më pëlqejnë vendimet e saj

Prapaskena

‘Prapaskena’ lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. ‘Prapaskena’ është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin,

Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

Kategoritë

KREU INVESTIGIM

KRIM & KORRUPSION DOSJE ROZË

KRYESORE POLITIKË EKONOMI

ANALIZË RAJON KULTURË SPORT

pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive
publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe
lidhjet e padukshme mes partive politike,
mediave të njësuar me interesat
klienteliste, krimit dhe biznesit jo të
ndershëm, të cilët në bashkëpunim
përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'



Email: [\[email protected\]](#)

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

[Privacy Policy](#) | [Cookies](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.